

**MARRËVESHJE**  
**PËR**  
**BASHKËPUNIM KULTUROR**  
**MIDIS**  
**MINISTRISË SË KULTURËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**DHE**  
**MINISTRISË SË KULTURËS SË REPUBLIKËS ÇEKE**

Ministria e Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Kulturës së Republikës Çeke (më poshtë referuar si "Palët"),

duke marrë në konsideratë Marrëveshjen midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Çeko- Sllovake mbi Bashkëpunimin Kulturor, nënshkruar në Tiranë më 1 Dhjetor 1952,

duke ndjekur interesin e përbashkët në forcimin dhe nxitjen e bashkëpunimit të mëtejshëm në fushën e kulturës midis tyre dhe me bindjen se ky bashkëpunim do të kontribuojë në miqësinë dhe mirëkuptimin e ndërsjellë midis dy popujve,

bien dakord si më poshtë:

**Neni 1**

**Qëllimi**

Qëllimi i marrëveshjes është të zhvillojë dhe promovojë bashkëpunimin kulturor mes Palëve, përmes shkëmbimit të përvojave dhe realizimit të politikave kulturore në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim për të ndërtuar dhe nxitur marrëdhënie dhe shkëmbimin kulturor.

**Neni 2**

**Bashkëpunimi Institucional**

Palët angazhohen të vendosin lidhje me qëllim krijimin e marrëdhënieve midis institucioneve kulturore kombëtare të trashëgimisë kulturore si dhe qendrave historike të Republikës së Shqipërisë me ato homologe në Çeki.

### Neni 3

#### Bashkëpunimi në Fushën e Trashëgimisë Kulturore

1. Palët do të mundësojnë shkëmbimin reciprok të çdo informacioni dhe bashkëpunimi midis institucioneve dhe administratës publike, të cilët kanë autorizim të dokumentojnë transferimet ndërkombëtare të pasurive kulturore, luftimin e trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore dhe kthimin e pasurive kulturore të eksportuara në mënyrë të paligjshme, për të mundësuar miratimin e procedurave për të parandaluar tregtinë e paligjshme të pasurive kulturore dhe për të lehtësuar kthimin e pasurive kulturore të eksportuara në mënyrë të paligjshme në vendin e tyre të origjinës.

Palët do të lehtësojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis autoriteteve që kanë të drejtë të komunikojnë kthimin e pasurisë kulturore të eksportuar në mënyrë të paligjshme.

2. Kur zbatohen masat për bashkëpunim në fushën e luftimit të trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore dhe kthimit të pasurive kulturore të eksportuara në mënyrë të paligjshme në vendin e origjinës, Palët do të ndajnë dhe zbatojnë procedurat bazuar në të drejtën ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar.
3. Palët do të nxisin, sipas mundësive më të mira të tyre, bashkëpunimin direkt dhe shkëmbimin e përvojës mbi praktikat institucionale në fushën e muzeve, trashëgimisë kulturore dhe menaxhimit të parqeve arkeologjike nëpërmjet organizimit të vizitave studimore dhe seminareve të trajnimit në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Çekisë.
4. Palët do të angazhohen për një bashkëpunim afatgjatë të drejtëpërdrejtë midis institucioneve dhe organizatave aktive në konservimin, restaurimin, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të luajtshme, të paluajtshme, të dokumentuar dhe jo-materiale të Shteteve të të dy Palëve, me një vëmendje të veçantë në shkëmbimin e praktikave të mira në menaxhimin e elementeve të parashikuar në ndonjë nga listat e trashëgimisë kulturore të administruar nga UNESCO.
5. Palët do të angazhohen, sipas mundësive më të mira të tyre, për të marrë pjesë në evente tradicionale dhe festivale, duke përfshirë pjesëmarrjen e grupeve të huaja folklorike, të organizuara në të dy vendet në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara nga këto festivale dhe organizatorët e ngjarjeve.
6. Palët do të informojnë njëra tjetrën për mundësinë e organizimit të "Javës së Trashëgimisë Kulturore".
7. Palët do të promovojnë, sipas mundësive më të mira të tyre, kontakte të drejtëpërdrejta midis krijuesve, artistëve dhe shoqatave kulturore-artistike në fushën e trashëgimisë kulturore jo materiale dhe shprehjeve të diversitetit kulturor si dhe do të angazhohen për

pjesëmarrjen e tyre në veprimtari të ndryshme dy a më shumëpalëshe ku ka interes reciprok.

8. Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin dhe do të lehtësojnë lidhjet e drejtpërdrejta midis institucioneve të specializuara të dy vendeve që janë përgjegjës për vlerësimin, regjistrimin e dokumentacionit, lëvizjen ndërkombëtare të certifikuar të trashëgimisë kulturore jo-materiale përfshirë shkëmbim të praktikave më të mira për çështjen e mbrojtjes nga trafikimi i paligjshëm i pasurive kulturore.
9. Palët do të lehtësojnë bashkëpunimin në fushën e trashëgimisë kulturore jo-materiale dhe do të promovojnë pjesëmarrjen në aktivitetet bilaterale ose multilaterale të Palës tjetër mbi bazën e interesit të përbashkët. Palët do të lehtësojnë lidhjet e drejtpërdrejta midis institucioneve përkatëse dhe do të promovojnë shkëmbimin e praktikave të mira në bërjen e inventarëve të trashëgimisë kulturore jo-materiale dhe në përgatitjen e emërimeve në listën e Përfaqësuesve të Trashëgimisë Kulturore Jo-materiale të Njerëzimit dhe Regjistrimit të Praktikave të Ruajtjes së Konventës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore jo-materiale (2003).

#### **Neni 4**

##### **Bashkëpunimi në fushën e librit**

1. Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin në fushën e industrisë së botimit dhe botimin e përkthimeve letrare nga dy vendet nëpërmjet:
  - a) Pjesëmarrjes në panairë librash që do të organizohen në të dy vendet;
  - b) Shkëmbimit të botimeve.

#### **Neni 5**

##### **Bashkëpunimi në fushën e artit**

1. Secila Palë do të informojë Palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike për datat e festivaleve të rëndësishme dhe ngjarjet e tjera kulturore / artistike që do të mbahen në vendet përkatëse.
2. Palët do të inkurajojnë dhe lehtësojnë, sipas mundësive më të mira të tyre, pjesëmarrjen e artistëve dhe trupave artistikë në festivale dhe ngjarje ndërkombëtare, shfaqje artistike dhe aktivitete të tjera kulturore që do të organizohen në të dy vendet.
3. Palët do të mundësojnë shkëmbimin e eksperiencave mes specialistëve të fushave të ndryshme të artit. Të vetëdijshëm për rëndësinë e artit joprofesionist për kulturën e tyre, Palët do të

